REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 683/5 prot. Tiranë, më 26.04 2022

V E N D I M

Nr. 21 datë 26.04 2022

"PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE TË CIKLIT TË DYTË,
QË JU REDUKTOHET TARIFA E SHKOLLIMIT 50%,
PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS"

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikës së Shqipërisë", të VKM nr. 780 dt. 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve, në IAL publike",, të Vendimit të Bordit të Administrimit nr.113 datë 30.07.2021 "mbi miratimin e tarifave të shkollimit për të dy ciklet e studimeve, në Universitetin e Sporteve të Tiranës", Vendimin e BA nr. 47 datë 29.10.2021" Për miratimin e dokumentacionit për përfitimin e bursës ose të përjashtimit nga tarifa e shkollimit për studentët e ciklit të parë dhe përjashtimin nga tarifa e shkollimit 50% për studentët e ciklit të dytë për vitin akademik 2021, relacioni i komisionit të shqyrtimit të dokumentave nr. 565 datë 04.02.2022, relacioni i komisionit të shqyrtimit dokumentacionit nr. 598 datë 08.04.2022 , Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 26.04. 2022,

V E N D O S I :

1. Të miratojë listën e studentëve të ciklit të dytë të studimeve, program i parë studimi, të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit që plotësojnë kriteret për të përfituar reduktim 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2021-2022, sipas shtojcës bashkëngjitur

2. Të miratojë listën e studentëve të ciklit të dytë që nuk plotësojnë kriteret për t'ju reduktuar tarifa e shkollimit 50%.

3. Ky vendim bashkë me listën e studentëve që përfitojnë nga ulja 50% e tarifës së shkollimit, për vitin akademik 2021-2022 dhe me efektet financiare të dërgohen në MAS.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqe www.ust.edu.al dhe tek trasparenca universitare.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Shtojca 1: Lista e studentëve të ciklit të dytë të studimeve, program i parë studimi, të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit që plotësojnë kriteret për të përfituar reduktim 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2021-2022,

Kriteri Nr. 2 Student qe vjen nga shtresa sociale : Student femije te personave /familjes me aftesi te kufizuar , te vertetuar me Vendim te KMC-A per pune , familjet e te cileve trajtohen/perfitojne nga Ligji nr 9355 date 10.03.2015 . Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore te ndryshuar , ndihmen ekonomike te plote apo te pjesshme nga njesite veteqeverisjes vendore

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot.	Data	Fakulteti	Programi	Viti	Përfitues i përjashtimit	Efekti Financiar
1	EF813G100046	K S	1765/16	08.12.2021	FSHL	MEFAP-G	1	Po	34,980
2	EF813G080146	S K	66/21	15.02.2022	FSHL	MEFAP-G	2	Po	34,980
Shuma totale									**69,960**

Kriteri Nr. 4 Student qe vjen nga shtresa sociale . Student der ne moshen 25 vjec qe kane vetem njerin nga prinderit pasi prindi tjeter eshte ndare nga jeta . Te ardhurat vjetore te familjes te pamjaftueshme per perballimin e kostos se studimeve .

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot.	Data	Fakulteti	Programi	Viti	Përfitues i përjashtimit	Efekti Financiar
1	EF813G090128	G M	66/12	02.02.2022	FSHL	MEFAP-G	2	Po (Te ardhurat familjare jane te pamjaftueshme)	34,980
Shuma totale									**34,980**

Shtojca 2 : Lista e studentëve të ciklit të dytë që nuk plotësojnë kriteret për t ju reduktuara tarifa e shkollimit 50%

Kriteri Nr. 2 Student qe vjen nga shtresa sociale : Student femije te personave /familjes me aftesi te kufizuar , te vertetuar me Vendim te KMC-A per pune , familjet e te cileve trajtohen/perfitojne nga Ligji nr 9355 date 10.03.2015 . Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore te ndryshuar , ndihmen ekonomike te plote apo te pjesshme nga njesite veteqeverisjes vendore

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot.	Data	Fakulteti	Programi	Viti	Përfitues i përjashtimit
1	EF813G100227	L P	1606/30	25.01.2022	FSHL	MEFAP-G	1	Jo , Masteri i dyte
2	EF813G100229	I P	1606/32	28.02.2022	FSHL	MEFAP-G	1	Jo , Masteri i dyte
3	EF813G100237	A T	1765/15	08.12.2021	FSHL	MEFAP-G	1	Jo , Masteri i dyte
4	EF813B100023	A U	1606/27	19.01.2022	FSHL	SHLB	1	Jo , Masteri i dyte